



Regjistroni
tani pajisjen
tuaj të re në MyBosch
dhe merrni përfitime
pa pagesë:
[bosch-home.com/
welcome](https://bosch-home.com/welcome)



Tharëse rrobash

WTX87M90BY

sq Udhëzuesi i përdorimit dhe instalimit

Tharësja juaj e re e rrobave

Ju keni vendosur për një tharëse rrobash të markës Bosch.

Ju lutemi shpenzoni disa minuta kohë për të lexuar dhe për të kuptuar avantazhet e tharëses suaj të re të rrobave.

Për të plotësuar kërkesat e larta të markës Bosch për cilësinë, çdo tharëse rrobash që del nga fabrika jonë kontrollonhet me kujdes për defekte dhe testohet për funksionimin e saj.

Më shumë informacione për produktet, aksesorët, pjesët e këmbimit dhe shërbimet tona do të gjeni në faqen tonë të internetit www.bosch-home.com ose mund të drejtoheni në qendrat tona të shërbimit për klientin.

Në vendet përkatëse jepen këshillat për ndryshimet e mundshme, nëse manuali i përdorimit dhe instalimit përshkruan modele të ndryshme.



Vëreni në punë tharësen e rrobave vetëm pasi të keni lexuar këtë manual përdorimi dhe instalimi!

Rregullat e paraqitjes

Paralajmërim!

Ky kombinim i simbolit dhe fjalës sinjalizuese mund të shkaktojë një situatë të rrezikshme. Nëse nuk i kushtohet vëmendje, mund të shkaktojë vdekjen ose plagosje.

Kujdes!

Kjo fjalë sinjalizuese mund të shkaktojë një situatë të rrezikshme. Nëse nuk i kushtohet vëmendje, mund të shkaktojë dëme të ambientit.

Udhëzim / Këshillë

Udhëzime për përdorimin optimal të pajisjes / informacione të dobishme.

1. 2. 3. / a) b) c)

Hapat e veprimeve do të paraqiten me numra ose gërma.

■ / -

Listat do të paraqiten përmes një tabele të vogël ose pikave.

Pasqyra e lëndës

 Qëllimi i përdorimit	4	Përfundimi i programit	29
 Udhëzimet e sigurisë	4	Heqja e rrobave dhe fikja e pajisjes	29
Fëmijët/njerëzit/kafshët shtëpiake	4	Zbrazja e mbajtësit të ujit të kondensuar	30
Instalimi	6	 Cilësimet e pajisjes	31
Puna e pajisjes	8	Siguresa për fëmijët	31
Pastrimi/mirëmbajtja	11	Sinjali udhëzues	31
 Udhëzime për kursim	13	Rregullimet bazë	31
 Instalimi dhe lidhja e pajisjes	13	 Lëreni ujin e kondensuar të rrjedhë	32
Përmbajtja e dërgesës	13	 Pastrimi dhe mirëmbajtja	35
Instalimi i pajisjes	14	Pastroni pajisjen	35
Lidhja e pajisjes	16	Pastroni dyshtemenë	36
Përpara përdorimit për herë të parë	17	Pastrojeni sensorin e lagështisë	39
Pajisja opsionale	17	Pastroni filtrin që ndodhet në mbajtësin e ujit të kondensuar	39
 Udhëzuesi i shkurtër	18	 Mirëmbajtja e pajisjes	40
 Njohja me pajisjen	19	Përgatitni mirëmbajtjen e pajisjes	41
Pamja e përgjithshme e pajisjes	19	Kryeni një mirëmbajtje të thjeshtë të pajisjes	42
Paneli	20	Bëni mirëmbajtjen intensive të pajisjes	43
 Ekrani	21	 Ndihmë për pajisjen	47
 Pasqyra e programeve	23	 Transportimi i pajisjes	50
 Rregullimet	25	 Vlerat e konsumit	51
 Rrobat	26	Tabela e vlerave të konsumit	51
Përgatitja e rrobave	26	Program efikas për tekstilet prej pambuku	51
Seleksionimi i rrobave	26	 Të dhënat teknike	52
 Përdorimi i pajisjes	27	 Hedhja e mbetjeve	52
Fusni rrobat dhe ndizni pajisjen	27	 Shërbimi i klientit	53
Zgjidhni programin	28		
Nisja e programit	28		
Fillon vijimi i programit	28		
Ndryshimi i programit ose shtimi i rrobave	29		
Ndërprerja e programit	29		



Qëllimi i përdorimit

- Kjo pajisje është projektuar vetëm për përdorim privat shtëpiak.
- Mos e instaloni apo përdorni këtë pajisje në vende ku ka shumë gjasa të ketë ngricë dhe/se ekspozim në kushtet e jashtme. Ka rrezik që pajisja të dëmtohet nëse uji i mbetur në të ngrin. Nëse tubat ngrijnë, mund të krisen/çahen.
- Kjo pajisje duhet të përdoret vetëm për të tharë dhe freskuar rroba normale, që konsistojnë në rroba që janë larë me ujë dhe janë të përshtatshme për tharje në kazan (shih etiketat tek rrobat). Përdorimi i pajisjes për qëllime të tjera është jashtë fushës së qëllimit për të cilin është krijuar kjo pajisje dhe është i ndaluar.
- Kjo pajisje është projektuar për t'u përdorur deri në një lartësi maksimale 4000 metra mbi nivelin e detit.

Përpara se të ndizni pajisjen:

Kontrolloni që të mos ketë dëme të dukshme në pajisje. Mos e përdorni pajisjen nëse është e dëmtuar. Nëse keni probleme, ju lutemi të kontaktoni shitësin tuaj të specializuar ose shërbimin tonë të klientit.

Lexoni dhe ndiqni udhëzimet e përdorimit dhe të instalimit si dhe gjithë informacionet e tjera të marra në dorëzime me pajisjen.

Ruajini dokumentet për përdorimin ose pronarët e ardhshëm.



Udhëzimet e sigurisë

Informacionet e mëposhtme të sigurisë dhe paralajmërimet jepen për t'ju mbrojtur nga lëndimet dhe për të parandaluar dëmet materiale përreth jush.

Megjithatë është e rëndësishme të merrni masat e nevojshme dhe të veproni me kujdes kur instaloni, mirëmbani, pastroni dhe përdorni pajisjen.

Fëmijët/njerëzit/kafshët shtëpiake



Paralajmërim Rrezik vdekjeje!

Fëmijët apo personat e tjerë që nuk arrijnë ta vlerësojnë rrezikun e mundshëm kur përdorin pajisjen mund të lëndohen apo mund të ndodhen në situata të rrezikshme për jetën. Prandaj ju lutem kini parasysh:

- Pajisja mund të përdoret nga fëmijë mbi 8 vjeç dhe nga persona me aftësi të reduktuara fizike, ndijore ose mendore ose nga persona me mungesë përvoja ose njohurish, me kusht që të jenë të mbikëqyrur ose të jenë udhëzuar sesi të përdorin pajisjen në mënyrë të sigurt dhe të kenë kuptuar rreziqet e mundshme të përdorimit të pajisjes.

- Fëmijët nuk duhet të luajnë me këtë pajisje.
- Mos i lejoni fëmijë ta pastrojnë ose ta mbajnë këtë pajisje të pambikëqyrur.
- Mbani larg pajisjes fëmijët nën 3 vjeç dhe kafshët shtëpiake.
- Mos e lini pajisjen pa mbikëqyrje kur fëmijët ose njerëz të tjerë që nuk kanë mundësi të vlerësojnë rreziqet ndodhen në afërsi.

Paralajmërim **Rrezik vdekjeje!**

Fëmijët mund të ngecin brenda pajisjeve duke rrezikuar jetën e tyre.

- Mos e poziciononi pajisjen pas një dërrë, pasi mund të pengojë derën e pajisjes ose të pengojë hapjen e saj të plotë.
- Kur pajisja arrin fundin e jetës së vet, hiqni spinën nga priza **para** se të pritni kabllin e korrentit e më pas shkatërroni bravën e derës së pajisjes.

Paralajmërim

Rrezik nga asfiksioni!

Nëse do t'i lejoni fëmijët të luajnë me fletët ambalazhuese/ plastike ose me elementët paketues, ata mund të ngecin në to ose të fusin kokën brenda tyre e të asfiksohen.

Mbani larg fëmijëve fletët plastike dhe elementët e paketimit.

Paralajmërim

Rrezik nga helmimi!

Detergjentet dhe produktet e kujdesit mund të rezultojnë helmues nëse konsumohen. Nëse e gëlltisni aksidentalisht, kërkoni këshillën e mjekut.

Mbani larg nga fëmijët detergjentet dhe produktet e kujdesit.

Paralajmërim

Irritimi i syve/lëkurës!

Kontakti me detergjentet dhe produktet e kujdesit mund të shkaktojnë irritim të syve/lëkurës.

Shpëlajini mirë sytë/lëkurën nëse keni prekur detergjentin apo produktet e kujdesit. Mbani larg nga fëmijët detergjentet dhe produktet e kujdesit.

Instalimi


Paralajmërim

Rrezik goditjeje elektrike/ zjarri/dëmsh materiale/ dëmtimesh në pajisje!

Nëse pajisja nuk është instaluar si duhet, kjo mund të bëhet një situatë e rrezikshme.

Sigurohuni për sa më poshtë:

- Tensioni i rrjetit në prizën tuaj duhet të përkojë me tensionin e specifikuar në pajisje (tabela e identifikimit). Ngarkesat e lidhura dhe mbrojtja e kërkuar e siguresës janë specifikuar në tabelën identifikuese.
- Kjo pajisje nuk duhet të furnizohet nga një pajisje komanduese e jashtme, si p.sh. një kohëmatës, apo të lidhet në një qark që ndizet dhe fiket rregullisht nga një program komandues.
- Spina e korrentit dhe priza me kontakt të mbrojtur duhet të përshtaten me njëra-tjetrën dhe sistemi i tokëzimit duhet të jetë instaluar si duhet.
- Instalimi duhet të ketë një diametër të përshtatshëm.

- Spina e korrentit duhet të jetë gjithmonë lehtësisht e arritshme. Nëse kjo nuk është e mundur, në mënyrë që të jeni në përputhje me rregullat përkatëse të sigurisë, një çelës (me shkëputje në gjithë polet) duhet të integrohet tek instalimi i qëndrueshëm sipas rregullores së instalimeve elektrike.
- Nëse do të përdorni një ndërprerës qarku të rrymës së mbetur, përdorni një çelës që mban shenjën e mëposhtme: . Prania e kësaj shenje është e vetmja mënyrë për t'u siguruar që i plotëson gjithë rregullat në fuqi.

Paralajmërim

Rrezik goditjeje elektrike/ zjarri/dëmsh materiale/ dëmtimesh në pajisje!

Nëse kabli kryesor i pajisjes është shformuar ose dëmtuar, kjo mund të shkaktojë goditje elektrike, qark të shkurtër ose zjarr si pasojë e mbinxehjes. Kabli i korrentit nuk duhet të jetë i përdredhur, i shtypur ose i shformuar dhe nuk duhet të bjerë në kontakt me burime nxehtësie.

⚠ Paralajmërim
Rrezik zjarri/dëmsh
materiale/dëmtimesh në
pajisje!

Përdorimi i kablllove zgjatues apo adaptorëve të korrentit mund të shkaktojë zjarr si pasojë e mbinxehjes ose e qarkut të shkurtër.

Lidheni pajisjen direkt me një prizë të tokëzuar të instaluar si duhet. Mos përdorni kablo zgjatues, adaptorë korrenti ose bashkues të shumëfishtë.

⚠ Paralajmërim
Rrezik lëndimi/zjarri/dëmsh
materiale/dëmtimesh në
pajisje!

- Pajisja mund të dridhet ose të lëvizë kur është duke punuar, si pasojë mund të shkaktojë lëndime ose dëme materiale.

Vendoseni pajisjen mbi një sipërfaqe të pastër, të sheshtë, solide dhe përdorni një nivelues për ta niveluar kur vidhosni këmbët e saj.

- Vendosja jo e duhur (stivë) e pajisjes mbi një makinë larëse mund të rezultojë në lëndime, dëme materiale dhe/ose dëme në pajisje. Nëse pajisja do të vendoset mbi një makinë larëse, makina larëse duhet të ketë minimalisht të njëjtën lartësi dhe gjerësi sa pajisja në fjalë dhe duhet të jetë siguruar në vend me lidhjet e duhura nëse janë disponibël.

→ *Faqja 17*

Pajisja DUHET të jetë e siguruar me këtë set lidhës. Vendosja e pajisjes mbi një pajisje tjetër në çfarëdolloj mënyre tjetër është e ndaluar.

- Nëse do ta ngrini apo lëvizni pajisjen duke e kapur tek ndonjë nga pjesët e dala të saj (p.sh dera e pajisjes), këto pjesë mund të thyhen dhe mund t'ju lëndojnë. Mos e lëvizni pajisjen duke e kapur tek ndonjë nga pjesët e saj të dala.

Paralajmërim **Rrezik lëndimi!**

- Pajisja është shumë e rëndë. Ngritja e saj mund të rezultojë në lëndimin tuaj. Mos e ngrini pajisjen i vetëm.
- Cepat e pajisjes janë shumë të mprehtë dhe mund t'ju presin duart. Mos e ngrini pajisjen duke e kapur tek cepat e saj të mprehtë. Vishni doreza mbrojtëse për ta ngritur atë.
- Nëse tubat dhe kablli i korrentit nuk janë vendosur si duhet, mund të bëhen shkak që të rrëzoheni, duke rezultuar në lëndimin tuaj. Vendosni tubat dhe kabllot në atë mënyrë që të mos përbëjnë rrezik.

Puna e pajisjes

Paralajmërim **Rrezik shpërthimi/zjarri!**

Rrobat që kanë pasur kontakt me tretës, heqës vaji, dylli, boje, graso apo njolla mund të marrin flakë kur thahen në pajisje ose mund të shkaktojnë edhe shpërthimin e pajisjes. Prandaj ju lutem kini parasysht:

- Shpëlani rrobat mirë me ujë të ngrohtë dhe detergjent para se ti thani në pajisje.
- Mos fusni rroba për tu tharë në pajisje, nëse ato nuk janë larë më parë.
- Mos e përdorni pajisjen nëse për larjen e rrobave janë përdorur kimikate industriale.

⚠ Paralajmërim**Rrezik shpërthimi/zjarr!**

- Nëse tek filtri i pusheve ka mbetur ndonjë mbetje, ajo mund të marrë flakë kur pajisja është në punë si dhe mund shkaktojë zjarr ose të shpërthejë pajisjen. Pastroni rregullisht filtrin e pushit.
- Disa objekte mund të marrin flakë kur pajisja është në punë si dhe mund shkaktojë zjarr ose të shpërthejë pajisjen. Hiqni çakmakët ose shkrepëset nga xhepat e rrobave.
- Nëse në ambientin për rreth pajisjes ka pluhur qymyri ose pluhur kjo mund të shkaktojë shpërthim. Sigurohuni që zona për rreth pajisjes të jetë e pastër përse kohë pajisja është në funksionim.

⚠ Paralajmërim**Rrezik zjarri/dëmtim objektsh/dëmtim në pajisje!**

Pajisja përmban R290, një substancë ftohëse që nuk ndot ambientin por që mund të marrë flakë.

Flakën e hapur dhe burimet e flakëve mbajini larg pajisjes.

**⚠ Paralajmërim****Rrezik zjarri/dëmtim objektsh/dëmtim në pajisje!**

Nëse një program përfundon para se cikli i tharjes të ketë përfunduar, atëherë rrobat mund të mos jenë ftohur mjaftueshëm dhe kjo mund të shkaktojë zjarr, ose mund të shkaktojë dëme materiale ose dëmtime në pajisje.

- Gjatë pjesës së fundit të ciklit të tharjes, rrobat në kazan nuk nxehen (cikli i ftohjes). Kjo bëhet për të qenë e sigurt se ato do të ruajnë një temperaturë e cila nuk i dëmton ato.
- Mos e fikni pajisjen para se cikli i tharjes të ketë përfunduar vetëm nëse do t'i hiqni të gjitha rrobat menjëherë nga kazani dhe do t'i ndeni direkt ato (për tu freskuar).

⚠ Paralajmërim**Rrezik helmimi/dëmsh materiale!**

Uji i kondensuar nuk është ujë i pijshëm dhe mund të jetë i kontaminuar me pluhura. Uji i kondensuar i kontaminuar mund të jetë i rrezikshëm për shëndetin dhe mund të shkaktojë dëme materiale. Mos e pini apo përdorni atë.

Paralajmërim

Rrezik nga helmimi!

Agjentët pastrues që përmbajnë tretës, p.sh tretës pastrues, mund të lëshojnë avuj helmues.

Mos përdorni agjentë pastrues që përmbajnë tretës.

Paralajmërim

Rrezik lëndimi!

- Nëse mbështeteni/uleni mbi derën e pajisjes kur ajo është e hapur, pajisja mund të përmbysset dhe mund t'ju lëndojë.
Mos u mbështetni/ulni mbi derën e pajisjes kur ajo është e hapur.
- Nëse hipni mbi pajisje, sipërfaqja e saj mund të thyhet dhe mund t'ju lëndojë.
Mos hipni mbi pajisje.
- Nëse prekni kazanin ndërkohë që është në rrotullim e sipër, rrezikoni të lëndoni duart tuaja.
Prisni derisa kazanin të ndalojë rrotullimin.

Kujdes!

Dëmtim objektesh/dëmtim në pajisje

- Nëse sasia e rrobave në kazan e tejkalon kapacitetin maksimal të ngarkesës, pajisja nuk do jetë në gjendje të punojë si duhet dhe kjo mund të rezultojë në dëme materiale ose në dëme në pajisje.
Mos e tejkaloni kapacitetin maksimal të ngarkesës të rrobave të thata. Sigurohuni që jeni brenda kapacitetit maksimal të ngarkesës të specifikuar për çdo program.
→ *Faqja 23*
- Nëse do ta përdorni pajisjen pa kapës pushi (p.sh filtër pushi, depozitë pushi, në varësi të specifikimeve të pajisjes), ose nëse kapësi i pushit nuk është i plotë ose është me defekt, kjo mund të dëmtojë pajisjen tuaj.
Mos e përdorni pajisjen pa kapësin e pushrave ose me një kapës pushrash që nuk është i plotë apo që është i dëmtuar.
- Objektet e lehta si flokët apo gazrat mund të thithen në tubat e ajrit kur pajisja është në punë.
Mbajini këto gjithmonë larg pajisjes.

- Shkuma dhe shkuma e detit mund të deformohet apo shkrihet kur thahet në pajisje. Mos thani në pajisje rroba me përmbajtje shkume apo shumë deti.
- Nëse hidhni sasinë e gabuar të detergjentit apo agjentit larës në pajisje, kjo mund të rezultojë në dëme materiale ose në dëmtime në pajisje. Detergjentet/produktet e kujdesit/agjentët pastrues dhe zbutësit përdorini në përputhje me udhëzimet e prodhuesve.
- Nëse pajisja nxehet shumë, ajo nuk do jetë në gjendje të punojë si duhet dhe kjo mund të rezultojë në dëme materiale ose në dëme në pajisje. Sigurohuni që tubat e ajrit të pajisjes të mos jenë asnjëherë të bllokuara kur pajisja është në punë dhe që ambienti për rreth pajisjes të jetë ajrosur si duhet.

Pastrimi/mirëmbajtja

Paralajmërim **Rrezik vdekjeje!**

Pajisja punon me energji elektrike. Ekziston rreziku i goditjes elektrike nëse do të prekni komponentët me tension. Prandaj ju lutem kini parasysh:

- Fikni pajisjen. Shkëpusni pajisjen nga rrjeti elektrik (hiqni spinën nga priza).
- Mos prekni ose mbani asnjëherë spinën me duar të njoma.
- Kur të hiqni spinën e korrentit nga priza, kapeni gjithmonë nga spina dhe asnjëherë nga kabllin e korrentit, përndryshe mund të dëmtoni kabllin e korrentit.
- Mos ndërmerrni asnjë modifikim teknik në pajisje apo në veçoritë e saj.
- Riparimet apo çdo punim tjetër në pajisje duhet të bëhen vetëm nga shërbimi ynë i klientit ose nga një elektrikist. E njëjta gjë vlen edhe kur duhet të ndërroni kabllin e korrentit (nëse do jetë e domosdoshme).
- Kabllot rezervë të korrentit mund të porositen tek shërbimi ynë i klientit.



Paralajmërim

Rrezik nga helmimi!

Agjentët pastrues që përmbajnë tretës, p.sh tretës pastrues, mund të lëshojnë avuj helmues.

Mos përdorni agjentë pastrues që përmbajnë tretës.



Paralajmërim

Rrezik goditjeje elektrike/ dëmsh materiale/dëmtimesh në pajisje!

Nëse në pajisje depërton lagështi, kjo mund të shkaktojë qark të shkurtër.

Mos përdorni një larës me presion, pastrues me avull, tub ose pistoletë spërkatëse për të pastruar pajisjen tuaj.



Paralajmërim

Rrezik lëndimi/zjarri/dëmsh materiale/dëmtimesh në pajisje!

Përdorimi i pjesëve të këmbimit dhe aksesorëve të markave të tjera është i rrezikshëm dhe mund të rezultojë në lëndime, dëme materiale ose në dëmtime në pajisje.

Për arsye sigurie, përdorni vetëm pjesë këmbimi dhe aksesorë origjinalë.

Kujdes!

Dëme materiale/dëmtime në pajisje

Agjentët larës dhe agjentë trajtues para larjes (p.sh. pastruesi i njollave, spërkatësit para larjes, etj.) mund të shkaktojnë dëmtime nëse bien në kontakt me sipërfaqen e pajisjes. Prandaj ju lutemi kini parasysh:

- Mos lejoni që këta agjentë të bien në kontakt me sipërfaqet e pajisjes.
- Pastrojeni pajisjen vetëm me ujë dhe me një pecetë të butë e të njomë.
- Pastrojini menjëherë mbetjet e detergjentit, spërkatësit apo mbetje të tjera.



Udhëzime për kursim

- Shtrydhni rrobat para tharjes. Rrobat e thata shkurtojnë kohëzgjatjen e programit duke ulur kështu konsumin e energjisë.
- Mbusheni pajisjen me sasinë maksimale të ngarkesës së programit.


Udhëzim: Tejkalimi i ngarkesës maksimale zgjat kohëzgjatjen e programit dhe rrit konsumin e energjisë.

- Përdorni pajisjen në një dhomë të ajrosur dhe mbajini vrimat e ajrimit të pajisjes të pabllokuara, në mënyrë që të realizohet shkëmbimi i ajrit.
- Hiqeni pushin vazhdimisht nga pajisja. Kur pajisja ka zënë push kohëzgjatja e programit zgjatet dhe konsumi i energjisë rritet.
- Nëse nuk e përdorni pajisjen për një kohë të gjatë përpara nisjes së programit apo pas përfundimit të tij, pajisja kalon automatikisht në modalitetin e kursimit të energjisë. Ekranin dhe llambat treguese fiket pas disa minutash dhe **Start/Reload** (Start/Pauzë) pulson. Modaliteti i kursimit të energjisë përfundon, kur ju përdorni sërish pajisjen, p.sh. nëse hapni dhe mbyllni derën.
- Nëse nuk e përdorni pajisjen për një kohë të gjatë pasi ajo kalon në modalitetin e kursimit të energjisë, atëherë pajisja fiket automatikisht.



Instalimi dhe lidhja e pajisjes

Përmbajtja e dërgesës



- 1 Dokumentet shoqërues (p.sh. udhëzuesi i përdorimit dhe instalimit)
- 2 Materiali fiksues
- 3 Manifoldi për fiksimin e tubit të shkarkimit
- 4 Tubi i shkarkimit
- 5 Adaptori i lidhjes

1. Hiqni plotësisht nga pajisja materialin e ambalazhit dhe qeset mbrojtëse.
2. Hapni derën.
3. Nxirrni të gjithë aksesorët nga kazan.

Tani mund të instaloni dhe të lidhni pajisjen.

Kujdes!

Dëmet materiale dhe dëmtimet e pajisjes

Objektet e mbetura brenda në kazan, që nuk janë parashikuar për punën në pajisje, mund të shkaktojnë dëme materiale dhe dëmtime të pajisjes. Nxirrni këto objekte, si dhe të gjithë aksesorët nga kazan.

Instalimi i pajisjes

⚠ Paralajmërim Rrezik vdekjeje!

Fëmijët mund të ngecin brenda pajisjeve duke rrezikuar jetën e tyre.

- Mos e poziciononi pajisjen pas një dere, pasi mund të pengojë derën e pajisjes ose të pengojë hapjen e saj të plotë.
- Kur pajisja arrin fundin e jetës së vet, hiqni spinën nga priza **para** se të pritni kabllin e korrentit e më pas shkatërroni bravën e derës së pajisjes.

⚠ Paralajmërim Rrezik shpërthimi/zjarri!

Nëse në ambientin për rreth pajisjes ka pluhur qymyri ose pluhur kjo mund të shkaktojë shpërthim.

Sigurohuni që zona për rreth pajisjes të jetë e pastër përse kohë pajisja është në funksionim.

⚠ Paralajmërim Rrezik zjarri/dëmtim objektësh/dëmtim në pajisje!

Pajisja përmban R290, një substancë ftohëse që nuk ndot ambientin por që mund të marrë flakë.

Flakën e hapur dhe burimet e flakëve mbajini larg pajisjes.



⚠ Paralajmërim Rrezik lëndimi/zjarri/dëmsh materiale/dëmtimesh në pajisje!

- Pajisja mund të dridhet ose të lëvizë kur është duke punuar, si pasojë mund të shkaktojë lëndime ose dëme materiale.
Vendoseni pajisjen mbi një sipërfaqe të pastër, të sheshtë, solide dhe përdorni një nivelues për ta niveluar kur vidhosni këmbët e saj.
- Vendosja jo e duhur (stivë) e pajisjes mbi një makinë larëse mund të rezultojë në lëndime, dëme materiale dhe/ose dëme në pajisje.
Nëse pajisja do të vendoset mbi një makinë larëse, makina larëse duhet të ketë minimalisht të njëjtën lartësi dhe gjerësi sa pajisja në fjalë dhe duhet të jetë siguruar në vend me lidhjet e duhura nëse janë disponibël. → *Faqja 17*
Pajisja DUHET të jetë e siguruar me këtë set lidhës. Vendosja e pajisjes mbi një pajisje tjetër në çfarëdo lloji mënyre tjetër është e ndaluar.
- Nëse do ta ngrini apo lëvizni pajisjen duke e kapur tek ndonjë nga pjesët e dala të saj (p.sh dera e pajisjes), këto pjesë mund të thyhen dhe mund t'ju lëndojnë.
Mos e lëvizni pajisjen duke e kapur tek ndonjë nga pjesët e saj të dala.

⚠ Parajlmërim **Rrezik lëndimi!**

- Pajisja është shumë e rëndë. Ngritja e saj mund të rezultojë në lëndimin tuaj.
Mos e ngrini pajisjen i vetëm.
- Cepat e pajisjes janë shumë të mprehtë dhe mund t'ju presin duart.
Mos e ngrini pajisjen duke e kapur tek cepat e saj të mprehtë. Vishni doreza mbrojtëse për ta ngritur atë.

Kujdes!

Dëmtim objektesh/dëmtim në pajisje

Nëse pajisja nxehet shumë, ajo nuk do jetë në gjendje të punojë si duhet dhe kjo mund të rezultojë në dëme materiale ose në dëme në pajisje.

Sigurohuni që tubat e ajrit të pajisjes të mos jenë asnjëherë të bllokuara kur pajisja është në punë dhe që ambienti për rreth pajisjes të jetë ajrosur si duhet.


Kujdes!

Dëmet materiale dhe dëmtimet e pajisjes

Përpara lëvrimin nga fabrika pajisja i është nënshtruar një prove funksionimi dhe mund të përmbajë ujë të mbetur nga kjo provë. Ky ujë i mbetur mund të zbrazet nëse pajisja anohet me një kënd mbi 40°.

Montojeni pajisjen si më poshtë:

1. Montojeni pajisjen mbi një sipërfaqe të pastër, të sheshtë dhe të qëndrueshme.
2. Kontrolloni nivelimin e pajisjes me nivelues uji.



3. Nëse është e nevojshme, nivelojeni sërish pajisjen përmes rrotullimit të këmbëzave të pajisjes.
Tani mund ta montoni dhe instaloni pajisjen.


Udhëzime

- Të gjitha këmbët e pajisjes duhet të qëndrojnë fort në dysheme.
- Në rast se pajisja nuk është e niveluar saktë, mund të ndodhin zhurma, dridhje dhe një lëvizje e e pabalancuar e kazanit, dhe nga pajisja mund të rrjedhë uji i mbetur.

Lidhja e pajisjes

Paralajmërim **Rrezik goditjeje elektrike/zjarri/ dëmsh materiale/dëmtimesh në pajisje!**

Nëse pajisja nuk është instaluar si duhet, kjo mund të bëhet një situatë e rrezikshme. Sigurohuni për sa më poshtë:

- Tensioni i rrejtë në prizën tuaj duhet të përkohet me tensionin e specifikuar në pajisje (tabela e identifikimit). Ngarkesat e lidhura dhe mbrojtja e kërkuar e siguresës janë specifikuar në tabelën identifikuese.
- Kjo pajisje nuk duhet të furnizohet nga një pajisje komanduese e jashtme, si p.sh. një kohëmatës, apo të lidhet në një qark që ndizet dhe fiket rregullisht nga një program komandues.
- Spina e korrentit dhe priza me kontakt të mbrojtur duhet të përshtaten me njëra-tjetrën dhe sistemi i tokëzimit duhet të jetë instaluar si duhet.
- Instalimi duhet të ketë një diametër të përshtatshëm.
- Spina e korrentit duhet të jetë gjithmonë lehtësisht e arritshme. Nëse kjo nuk është e mundur, në mënyrë që të jeni në përputhje me rregullat përkatëse të sigurisë, një çelës (me shkëputje në gjithë polet) duhet të integrohet tek instalimi i qëndrueshëm sipas rregullores së instalimeve elektrike.
- Nëse do të përdorni një ndërprerës qarku të rrymës së mbetur, përdorni një çelës që mban shenjën e mëposhtme: . Prania e kësaj shenje është e vetmja mënyrë për t'u siguruar që i plotëson gjithë rregullat në fuqi.

Paralajmërim **Rrezik goditjeje elektrike/zjarri/ dëmsh materiale/dëmtimesh në pajisje!**

Nëse kablli kryesor i pajisjes është shformuar ose dëmtuar, kjo mund të shkaktojë goditje elektrike, qark të shkurtër ose zjarr si pasojë e mbinxehjes.

Kablli i korrentit nuk duhet të jetë i përdredhur, i shtypur ose i shformuar dhe nuk duhet të bjerë në kontakt me burime nxehtësie.

Paralajmërim **Rrezik zjarri/dëmsh materiale/ dëmtimesh në pajisje!**

Përdorimi i kabllove zgjatues apo adaptorëve të korrentit mund të shkaktojë zjarr si pasojë e mbinxehjes ose e qarkut të shkurtër.

Lidheni pajisjen direkt me një prizë të tokëzuar të instaluar si duhet. Mos përdorni kablllo zgjatues, adaptorë korrenti ose bashkues të shumëfishtë.


Paralajmërim **Rrezik lëndimi!**

Nëse tubat dhe kablli i korrentit nuk janë vendosur si duhet, mund të bëhen shkak që të rrëzoheni, duke rezultuar në lëndimin tuaj.

Vendosni tubat dhe kabllot në atë mënyrë që të mos përbëjnë rrezik.

Instalojeni pajisjen si më poshtë:

1. Lidhni tubin e shkarkimit.
→ *Faqja 32*



2. Futni spinën e kordonit elektrik të pajisjes në prizën e parashikuar.
 3. Kontrolloni qëndrimin e fortë të spinës.
- Tani pajisja është gati për punë.

Kujdes!

Dëmtime fizike dhe dëmtime në pajisje

Pajisja përmban lëndë ftohëse dhe mund të dëmtohet, nëse vihet në punë menjëherë pas transportit. Dy orë para se ta vini në punë, lëreni pajisjen të qëndrojë në qetësi.

Udhëzim: Në raste dyshimi, lëreni që pajisja të instalohet nga një specialist i kualifikuar.

Përpara përdorimit për herë të parë

Përpara se të ndizni pajisjen:

Kontrolloni që të mos ketë dëme të dukshme në pajisje. Mos e përdorni pajisjen nëse është e dëmtuar. Nëse keni probleme, ju lutemi të kontaktoni shitësin tuaj të specializuar ose shërbimin tonë të klientit.

Udhëzim: Pas montimit dhe lidhjes së saktë, pajisja është gati për punë. Masa të tjera nuk janë të nevojshme.

Pajisja opsionale











Porositni aksesoren opsional* tek shërbimi i klientit:

- **Koshi i rrobave:**
Tekstilet prej leshi, atletet dhe lodrat e pelushit thajini në koshin e rrobave.
– Numri i porosisë: **WMZ20600**.
- **Podium:**
Vendosni tharësen tuaj mbi një podium në mënyrë që të mund ta mbushni dhe zbrazni me lehtësi. Ju mund t'i transportoni rrobat me koshin e integruar në sirtarin e bazamentit.
– Numri i porosisë: **WTZPW20D**.
- **Lidhësja e kolonës larje-tharje:**
Për të kursyer vend, ju mund ta vendosni tharësen mbi një lavatriçe të përshtatshme me të njëjtën lartësi dhe gjerësi.
Fiksojeni tharësen mbi makinën larëse vetëm me këtë lidhëse.
– Numri i porosisë me pllakën e punës që mund të hiqet: **WTZ27400**
– Numri i porosisë pa pllakë pune që hiqet: **WTZ27410**.
- **Seti i instalimit:**
Ujin e kondensuar të pajisjes mund ta nxirrni edhe përmes një tubi shkarkimi në ujërat e zeza. Në këtë rast nuk duhet ta boshatisni mbajtësen e ujit të kondensuar gjatë tharjes si dhe pas tharjes.
– Numri i porosisë: —

* sipas përbërjes së pajisjes


Udhëzuesi i shkurtër

Udhëzim: Pajisja duhet të jetë instaluar dhe lidhur si duhet. → *Faqja 13*

1	Para startimit të programit:			
		Seleksionimi i rrobave.	Ndizni pajisjen.	Zgjidhni programin.
2				
	Hapni derën dhe fusni rrobat.	Mbyllni derën.	Sipas nevojës: Ndryshojini rregullimet e programit.	Startoni programin.
3	Pas përfundimit të programit:			
		Fikni pajisjen.	Hapeni derën dhe nxirrni rrobat.	Zbraza e mbajtëses së ujit të kondensuar.


Njohja me pajisjen

Pamja e përgjithshme e pajisjes



- 1** Mbajtësi i ujit të kondensuar → *Faqja 30*
- 2** Kapaku mbulues
- 3** Ndrëçimi i brendshëm i kazanit (sipas pajimit të pajisjes)
- 4** Vrima e futjes së ajrit
- 5** Kapaku i mirëmbajtjes në bazament → *Faqja 36*
- 6** Dera
- 7** Mbulesa e kanalit të ajrit (mos e hiqni)

Paneli



1

Programi

2

Programatori

■ Rrotullimi: Vendosni programin

■ Shtypja: Ndizni/fikni pajisjen

3

Ekrani


Tregues i cilësimeve dhe informacioneve















4

Butonat

Për cilësimet e programeve dhe funksionet shtesë/cilësimet e pajisjes








 Ekрани










Treguesi	Përshkrimi	Informacionet
	Statusi i programit:	ndriçon: treguesi i statusit
	Tharja	
	E thatë për hekurosje	
	E thatë për dollap	
	Mbrojtja nga rrudhat	
<i>P-</i>	Pauzë	
<i>End</i>	Përfundimi i programit	
	Tharja e synuar	Tharja e synuar  E thatë për dollap plus e aktivizuar
		Tharja e synuar  E thatë për dollap e aktivizuar
		Tharja e synuar  Tharje me hekurosje e aktivizuar
  	Shkalla e tharjes	Shkalla e tharjes për një rezultat tharjeje e aktivizuar
p.sh. 1:27	Kohëzgjatja e programit	Kohëzgjatja e pritshme e programit në orë dhe minuta.
3h	Përfundimi i programit	Shtyrja e programit në orë, nëse keni aktivizuar opsionin Koha e përfundimit.
	Programi kohor	Programi kohor i aktivizuar






	Zbrazni mbajtësen e ujit të kondensuar → <i>Faqja 30</i>	<ul style="list-style-type: none"> ■ Zbrazni dhe përdorni mbajtësen e ujit të kondensuar. → <i>Faqja 30</i> Në fund shtypni tek Start/ Reload (Start/ Paузë). ■ Pastroni filtrin që ndodhet në mbajtësin e ujit të kondensuar. ■ Kur tubi opsional i shkarkimit* është instaluar, sigurohuni që tubi i shkarkimit: <ul style="list-style-type: none"> - është lidhur në mënyrë të saktë. → <i>Faqja 32</i> - është vendosur i papërdredhur. - nuk ka bllokim ose pengesa, p.sh. si pasojë e depozitimeve. ■ Bëni mirëmbajtjen intensive të pajisjes. ■ Kontrolloni, nëse ka objekte të huaja në dysheme. Hapni kapakun e mirëmbajtjes, për të larguar elementët e huaj.
	Bazamenti	Pastrimi i bazamentit → <i>Faqja 36</i>
	Shpëlarje automatike e shkëmbyesit të nxehtësisë	Shkëmbyesi i nxehtësisë do të pastrohet automatikisht. Mos e nxirrni jashtë mbajtësen e ujit të kondensuar gjatë procesit të treguar dhe mos e ndërpritni programin.
<i>CrE</i>	Mirëmbajtjen e thjeshtë të pajisjes	Nuk është defekt. Pas një kohë të caktuar përdorimi vetë pajisja rekomandon automatikisht një proces mirëmbajtje të thjeshtë. Kryeni një mirëmbajtje të thjeshtë të pajisjes. → <i>Faqja 42</i>
<i>Hot</i>	CoolDown	<p>Gjatë tharjes mund të krijohen temperatura të larta. Procesi CoolDown ul temperaturën në kazan për të ftohur rrobat. Kur dera nuk hapet, procesi CoolDown nis automatikisht pas 30 sekondash në rastet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ programi vendoset në pauzë ■ programi ndërpritet <p>Ju mund të vazhdoni më tej përdorimin e pajisjes edhe gjatë procesit CoolDown.</p> <p>Udhëzime</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Kazani vazhdon të rrotullohet gjatë procesit CoolDown edhe kur pajisja është në gjendje pauze. ■ Mos e ndryshoni programin gjatë procesit CoolDown. ■ Rregullimi i temperaturës mund të zgjasë deri në 10 minuta.


Pasqyra e programeve

Programi	ngarkesa maksimale
Emri i programit Shpjegim i shkurtër i programit respektivisht për cilat tekstilet është i përshtatshëm ai.	ngarkesa maksimale e bazuar në peshën e tekstileve të thata
Cottons (Pambuk)  Tekstile të qëndrueshme, tekstile prej pambuku ose pëlhure, të qëndrueshme nga zierja.	9 kg
Easy-Care (Larje e thjeshtë)  Tekstile sintetike dhe pëlhura të përziera.	3,5 kg
Mix (Miks)  Mbushje e përzier me tekstile prej pambuku dhe sintetike.	3 kg
Delicates (Veshje delikate)  Tekstile delikate, që mund të lahen, p. sh. prej sateni, sintetike ose materialesh të përzier.	2 kg
Wool Finish (Lesh)  Tekstile të leshta ose me pjesë të leshta që lahen në makinë larëse.	0,5 kg
Udhëzime <ul style="list-style-type: none"> ■ Tekstilet bëhen me push, por nuk janë tharë plotësisht. ■ Nxirrini tekstilet pas mbarimit të programit dhe lërinë të thahen. 	
Time Program Cold (Programi kohor i ftohtë)  Programi kohor për të gjitha tekstilet prej leshi dhe mëndafshi. Për rifreskimin ose ajrosjen e rrobave të veshura pak. Udhëzim: Ju mund të përshtatni kohëzgjatjen e programit.	3 kg
Time Program Warm (Programi kohor ngrohtë)  Program kohor për gjithë llojet e tekstileve përveç mëndafshit. I përshtatshëm për rroba të thara më parë ose për rroba pak të njoma dhe për tharjen e mëtejshme të rrobave me shumë shtresa e të trasha. Udhëzime <ul style="list-style-type: none"> ■ Rrobat prej leshi, këpucët e sportit dhe lodrat e pelushit thaheni gjithmonë me kosh. ■ Tek programi i kohës lagështia e mbetur e rrobave nuk identifikohet automatikisht. Nëse rrobat janë akoma shumë të njoma edhe pas tharjes, përsërisni programin dhe zgjasni kohëzgjatjen e tij. 	3 kg ngarkesa maks. për të leshtat/lodrat prej pelushi në kosh: 1 mbushje e koshit ngarkesa maks. për këpucët në kosh: 1 palë

<p>Shirts/Blouses (Bluza/këmisha) </p> <p>Këmisha/bluza prej pambuku, linoje, sintetike ose të përziera.</p> <p>Udhëzim: Pas tharjes, hekurosini teshat ose varini ato. Lagështia e mbetur shpërndahet njëtrajtshmërisht.</p>	<p>1,5 kg</p>
<p>Duvet (Jorganë) </p> <p>Tekstilet, jastëkët, batanijet ose jorganët e hollë e mbushur me fibra sintetike.</p> <p>Udhëzim: Pjesët e mëdha të thahen veç e veç. Vini re simbolet në etiketë.</p>	<p>2,5 kg</p>
<p>Down (Veshje prej feshi) </p> <p>Tekstile, mbulesa krevati ose batanije të mbushura me pupla.</p> <p>Udhëzime</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Pjesët e mëdha thani veç e veç. ■ Pas përfundimit të programit tekstilet të shkuden, për të shpërndarë mbushjen dhe për të hequr lagështinë. Sipas nevojës programi të ristartohet. 	<p>1,5 kg</p>
<p>Sportswear </p> <p>Veshjet që thahen shpejt prej fibrash funksionale dhe sintetike.</p>	<p>1,5 kg</p>
<p>Towels (Peshqirë) </p> <p>Peshqirë të fortë dhe robdeshambre prej pambuku.</p>	<p>6 kg</p>
<p>Super Quick 40' (Ekstra i shkurtër 40') </p> <p>Ngarkimi i përzier prej sintetike dhe pambuku të lehtë.</p>	<p>1 kg</p>
<p>AllergyPlus (Higjena) </p> <p>Tekstile të forta.</p> <p>Udhëzim: Programi arrin temperatura më të larta. Veçanërisht e përshtatshme kur kërkohet higjienë e veçantë.</p>	<p>4 kg</p>

P+ Rregullimet

Cilësimi i programit	Funksioni
Udhëzim:	Disa cilësimet nuk mund të aktivizohen në të gjitha programet. Cilësimet e aktivizuara tregohen të butonat ose theksohen të shndritshme në ekran. Ju mund t'i ndryshoni ose t'i çaktivizoni cilësimet e aktivizuara duke shtypur disa herë mbi butonin përkatës.
 Drying Aim ☼ (Qëllimi i tharjes):	Tharja e synuar përcakton sesa të lagështa ose të thata duhet të jenë rrobat pas përfundimit të programit. Nëse keni vendosur një nivel të tharjes së synuar, ky cilësim mbetet i ruajtur edhe pas fikjes së programit, për programin përkatës. Përjashtim: Tek të pambuktat këto cilësimet nuk ruhen.
 E thatë për dollap plus	Për rroba të trasha, me shumë shtresa, që nuk thahen mirë.
 E thatë për dollap	Për rroba me trashësi normale, me një shtresë.
 Tharje me hekurosje	Për rroba me trashësi normale, me një shtresë që pas tharjes duhet të jenë të lagështa dhe janë të përshtatshme për hekurosje apo për t'u nderur.
Drying Level ☼ (Niveli i tharjes)	Nëse pas tharjes rrobat ju duken shumë të njoma, atëherë ju mund të përshtatni shkallën e tharjes sipas rezultatit të tharjes dhe ta rritni midis nivelit ☼ deri në ☼☼☼. Kjo zgjat kohëzgjatjen e programit kur temperatura mbetet e njëjtë. Nëse keni përshtatur shkallën e tharjes për një rezultat tharjeje, ky cilësim ruhet edhe pas fikjes së pajisjes.
— Finished in + ⏱ (Gati në)	Përpara nisjes së programit ju mund ta shtyni përfundimin e programit me — dhe + maksimumi deri në 24 orë. Në ekran tregohet numri i orëve të vendosura, p.sh. 8h, dhe ky numër zvogëlohet në rend zbritës deri në fillimin e programit. Pas nisjes së programit tregohet kohëzgjatja e programit. Udhëzim: Ju lutemi të respektoni udhëzimet për temperaturën e mjedisit → <i>Faqja 52.</i>
— Finished in + ⏱	Koha e tharjes të  programi kohor mund të zgjatet me — dhe + në hapa me nga 10 minuta.
— / +	Me butonat e përshtatjes — dhe + ju mund të përshtatni vlerat e vendosjes.
Less Ironing ☺ 60' (Më pak hekurosje 60')	Pas përfundimit të tharjes, kazani i lëviz rrobat në distanca të rregullta, për të shmanhur kështu rrudhosjen e tyre. Ju mund ta aktivizoni funksionin automatik të mbrojtjes kundër rrudhave për 60 minuta (me Less Ironing ☺ 60' (Më pak hekurosje 60')) ose për 120 minuta (me Less Ironing ☺ 120' (Më pak hekurosje 120')) ose ta çaktivizoni atë.
Less Ironing ☺ 120' (Më pak hekurosje 120')	
Gentle 🌿 (I butë)	Temperatura e reduktuar për tekstile delikate si p.sh akriliku apo materialet elastike, mund të zgjasë kohën e tharjes.
Start/Reload ⏮ ⏭ (Start/Pauzë)	Për të nisur, pezulluar dhe ndërprerë një program.



Rrobat

Përgatitja e rrobave



Paralajmërim

Rrezik shpërthimi/zjarri!

Disa objekte mund të marrin flakë kur pajisja është në punë si dhe mund shkaktojë zjarr ose të shpërthejë pajisjen.

Hiqni çakmakët ose shkrepëset nga xhepat e rrobave.

Kujdes!

Dëme në kazan dhe tekstile

Kazani dhe tekstilet mund të dëmtohen gjatë funksionimi, nëse lini objekte në xhepat e tekstileve. Nxirrni nga xhepat e tekstileve gjithë objektet, si p.sh. objektet metalike.

Përgatitni rrobat si më poshtë:

- Ribat prej cope që mund të kenë rrobat tuaja lidhini sëbashku ose përdorni një qese larëse.
- Mbyllni zinxhirët, grepat, kapëset dhe kopsat. Kopsitni rrobat e mëdha, si p.sh. çarçafët dhe këllëfët e jastëkëve.
- Thajini gjithmonë tekstilet shumë të vogla, p.sh. çorapet e gjata të fëmijëve, së bashku me rroba të mëdha, p.sh. peshqirë.
- Përdorni një program kohor për rroba individuale.
- Rrobat p.sh bluzat dhe trikot e punuara me shtiza shpesh gjatë tharjes së parë tkurren. Përdorni një program për rroba delikate.

- Mos i thani më shumë seç duhet rrobat që mirëmbahen lehtë. Kjo mund t'i zhubrosë shumë rrobat.
- Disa detergjente dhe produkte kujdesi për rrobat, p.sh. forcues ose zbutës rrobash, përmbyjnë grimca që mund të depozitohen në sensorin e lagështisë. Kjo gjë mund të ndikojë në funksionimin e sensorit dhe për rrjedhojë në rezultatin e tharjes.

Udhëzime

- Dozoni gjatë larjes sipas të dhënave të prodhuesit sasinë e detergjentit dhe produktit të kujdesit për rrobat që do të thahen shumë.
- Pastroni rregullisht sensorin e lagështisë → *Faqja 39*.

Seleksionimi i rrobave

Udhëzim: Fusni rrobat e veçanta në pajisje. Shmangni koklavitjen e rrobave, për të përfutur një rezultat të mirë të tharjes.

Kujdes!

Tharësja dhe tekstilet mund të dëmtohen

Për rrobat e papërshtatshme për tharjen në tharëse, pajisja dhe rrobat mund të dëmtohen gjatë tharjes. Klasifikoni rrobat para tharjes, sipas të dhënave në etiketën e kujdesit:

- Të përshtatshme për tu larë në të thatë
- Tharja me temperaturë normale
- Tharje me temperaturë të ulët
- Mos i thani në tharëse

Gjatë klasifikimit të rrobave që do thani, bëni kujdes sa më poshtë:

- Prandaj thani së bashku vetëm rroba me përbërje të njëjtë dhe me strukturë të njëjtë që të keni rezultat të njëjtë në tharje. Nëse do të thani së bashku rroba të holla, të trasha ose me shumë shtresa, atëherë rezultati i tharjes do të jetë i ndryshëm te secila nga rrobat.
- Ndiqni përshkrimin e tekstileve të programit të tharjes.
→ "Pasqyra e programeve" në faqen 23

Udhëzim: Nëse pas tharjes, rrobat ju duken shumë të njoma, mund të zgjidhni një program kohor për tharjen e mëpasme.

Kujdes!

Dëme materiale në pajisje ose në tekstile

Mos i thani tekstilet e mëposhtme në tharëse:


- Rroba të ndotura me tretësira, dyll ose yndyrë.
- Tekstilet e palara.
- Tekstilet e padepërtueshme nga ajri, p.sh. rrobat e gomuara.
- Tekstilet delikate, p.sh. prej mëndafshi, perdet sintetike.




Përdorimi i pajisjes


Fusni rrobat dhe ndizni pajisjen

Udhëzim: Pajisja duhet të jetë instaluar dhe lidhur si duhet. → *Faqja 13*


1. Përgatitni më parë dhe seleksiononi rrobat.
2. Shtypni , për të ndezur pajisjen.




3. Hapni derën. Kontrolloni nëse kazani është boshatisur plotësisht. Nëse është nevoja, zbrazeni atë.



4. Vendosini rrobat në kazan pa i palosur.




5. Mbyllni derën.



Kujdes!

Janë të mundura dëmet materiale në pajisje ose në tekstile.

Asnjë plaçkë nuk ngec tek dera.




Udhëzim: Pasi hapjes, mbylles dhe startimit të programit, kazan i pajisjes ndriçon. Ndriçimi i brendshëm i kazanit fiket vetë.

Zgjidhni programin

Udhëzim: Aktivizoni sistemin e sigurisë së fëmijëve, nëse ju duhet ta çaktivizoni para se të vendosni një program.

→ *Faqja 31*

1. Programatori të vendoset në programin e dëshiruar.



Në ekran shfaqen rregullimet e programeve.

2. Kur dëshirohet, përshtatni cilësimet e programit.

Nisja e programit

Shtypni mbi **Start/Reload**(Start/Pauzë).

Udhëzim: Nëse dëshironi ta siguron programin kundër ndryshimit pa dashje, aktivizoni siguresën për fëmijët si më poshtë. → *Faqja 31*

Fillon vijimi i programit

Gjendja e programit do të shfaqet në ekran.

Udhëzim: Gjatë zgjedhjes së një programi tregohet kohëzgjatja e parashikuar e tharjes për mbushjen maksimale. Gjatë tharjes, sensori i lagështisë përcakton lagështinë e mbetur tek rrobat. Sipas lagështisë së mbetur, kohëzgjatja e programit treguesi i kohës së mbetur gjatë procesit përshtaten automatikisht (përveç programeve me kohë).

Ndryshimi i programit ose shtimi i rrobave

Gjatë tharjes ju mund nxirrni, të fusni rroba apo të ndryshoni dhe përshtatni programin në çdo kohë.

1. Hapni derën ose shtypni **Start/Reload** (Start/Pauzë) për një pushim.
Udhëzim: Nëse CoolDown është aktiv, atëherë kazanin vazhdon rrotullimin edhe në qëndje të stopuar. Ju mund ta stoponi CoolDown në çdo moment duke hapur derën.
2. Fusni ose nxirrini rrobat.
3. Nëse dëshironi, zgjidhni një program tjetër ose një rregullim tjetër programi. → "Pasqyra e programeve" në faqen 23

Udhëzim: Mos e ndryshoni programin gjatë CoolDown.

4. Mbyllni derën.
5. Shtypni mbi **Start/Reload** (Start/Pauzë).

Udhëzim: Kohëzgjatja e programit e shfaqur në ekran aktualizohet në varësi të ngarkesës dhe lagështisë së mbetur të rrobave. Vlerat e shfaqura mund të ndryshojnë sipas një programi ose ndryshimit të ngarkesës.

Ndërprerja e programit

Programi mund të ndërpritet në çdo kohë, kur ju hapni derën ose kur shtypni **Start/Reload** (Start/Pauzë).

Kujdes!

Rrezik djegieje. Rrobat mund të marrin flakë.


Nëse Ju ndaloni programin atëherë Ju duhet të nxirrni rrobat dhe t'i hapni ato në mënyrë që ato të ftohen.

Përfundimi i programit


Në ekran shfaqet udhëzimi: *End*

Heqja e rrobave dhe fikja e pajisjes

1. Nxirrini rrobat.



2. Shtypni **⓪**, për të fikur pajisjen.




Zbrazja e mbajtësit të ujit të kondensuar


Gjatë tharjes në pajisje krijohen ujë i kondensuar.

Nëse nuk përdorni tub shkarkimi, uji i kondensuar kalon tek mbajtësi i ujit të kondensuar. Në këtë rast mbajtësi i ujit të kondensuar duhet të zbrazet pas çdo procesi tharjeje, madje edhe gjatë tharjes kur është mbushur plot.

1. Nxirreni mbajtësen e ujit të kondensuar horizontalisht.



2. Derdheni ujin e kondensuar.




Kujdes!

Janë të mundura dëmtime të shëndetit dhe dëme materiale

Uji i kondensuar nuk është ujë i pijshëm dhe mund të jetë i ndotur me push. Uji i kondensuar dhe i ndotur mund të shkaktojë probleme shëndetësore apo të dëmtojë objektet përreth. Mos e pini dhe mos e përdorni për qëllime të tjera.

3. Fusni sërish mbajtësen e ujit të kondensuar në pajisje derisa ta dëgjoni të kërcasë.



Udhëzim: Filtri në mbajtësin e ujit të kondensuar filtron ujin e kondensuar, i cili përdoret për pastrimin automatik të pajisjes tuaj. Filtri pastrohet përmes zbrazjes së ujit të kondensuar. Gjithsesi kontrollojeni filtrin rregullisht për mbetje të ndryshme dhe në rast nevojë, hiqni ato nëse ka.

→ "Pastroni filtrin që ndodhet në mbajtësin e ujit të kondensuar" në faqen 39



Cilësimet e pajisjes

Ju mund të përshtatni ose të aktivizoni/çaktivizoni siguresën për fëmijët dhe rregullimet bazë (p.sh. sinjalet).

Siguresa për fëmijët

Me aktivizimin e siguresës së fëmijëve ju pengoni ndezjen e pavullnetshme të pajisjes.

Aktivizimi/çaktivizimi i sistemit të sigurisë së fëmijëve:

- **Child Lock 3 sec.** (Sistemi i sigurisë për fëmijët 3sek.) shtypni për 3 sekonda.

Udhëzim: Sistemi i sigurisë së fëmijëve qëndron aktiv edhe pas fikjes së pajisjes. Që të mund të komandoni pajisjen pas ndezjes, duhet të çaktivizoni siguresën e fëmijëve.

Sinjali udhëzues

Ju mund ta aktivizoni ose ta çaktivizoni sinjalin udhëzues në përfundim të programit. Kur ju aktivizoni këtë cilësim, në përfundim të programit tingëllon një sinjal akustik.

Aktivizoni/çaktivizoni cilësimin e pajisjes si në vijim:

Shtypni mbi **Signal** (Sinjali).


Sinjali udhëzues në përfundim të programit aktivizohet/çaktivizohet.

Udhëzim: Kur në përfundim të programit nuk tingëllon asnjë sinjal akustik ndonëse sinjali udhëzues është i aktivizuar, ju mund ta përshtatni cilësimin e pajisjes.


Rregullimet bazë

Ju mund të përshtatni rregullime bazë të caktuara të pajisjes suaj. Për të kryer përshtatjet e preferuara, fillimisht duhet të hyni te **Modaliteti i rregullimit**:

1. Vendosni programin në pozicionin **1**.




2. Shtypni mbi **Drying Aim** (Qëllimi i tharjes) dhe në të njëjtën kohë:
3. Vendosni programin në pozicionin **2**.



4. Lini të lirë  **Drying Aim** .
Modaliteti i rregullimit aktivizohet.

Rregullimet bazë u janë caktuar pozicioneve të mëposhtme të programeve:



Pozicioni	Rregullimi bazë
<input type="checkbox"/> 2	Përshtatni volumin e sinjaleve paralajmëruese (p.sh. në përfundim të programit).
<input type="checkbox"/> 3	Përshtatni volumin e sinjaleve të përdorimit.

Vlerat e vendosjes:

- 0 Fikur
- 1 E ulët
- 2 Mesatare
- 3 E lartë
- 4 Shumë e lartë

Përshtatja dhe aktivizimi/çaktivizimi i rregullimeve bazë

1. Përcaktoni pozicionin e rregullimit bazë të preferuar.
2. Ndryshoni cilësimin me:
— +
3. Përshtatni rregullimet e tjera bazë ose ruani rregullimet bazë dhe përfundoni veprimin.

Ruani dhe përfundoni rregullimet bazë si më poshtë

Fikni pajisjen.

Udhëzim: Cilësimet qëndrojnë të ruajtura edhe pas fikjes së pajisjes.



Lëreni ujin e kondensuar të rrjedhë


Gjatë tharjes në pajisje krijohen ujë i kondensuar.

Përdoreni pajisjen me tubin e shkarkimit të lidhur.


Nëse nuk përdorni tub shkarkimi, uji i kondensuar kalon tek mbajtësi i ujit të kondensuar. Në këtë rast mbajtësi i ujit të kondensuar duhet të zbrazet pas çdo procesi tharjeje, madje edhe gjatë tharjes kur është mbushur plot.

Lidhni tubin e shkarkimit si më poshtë:


1. Nxirreni aksesorin nga kazani.



2. Nxirri të gjitha pjesët nga qesja.




3. Hiqni tapën e mbylljes nga tubi bashkues.




Udhëzime

- Në gjendjen e dorëzimit të pajisjes, tapa e mbylljes është e mbërthyer tek tubi bashkues.
 - Kur hiqet tapa e mbylljes mund të rrjedhë pak ujë nga tubi bashkues.
4. Shtyni tapën e mbylljes në pozicionin e ndalimit.




5. Shtyni tubin e shkarkimit deri në fund në tubin bashkues të lirë.




6. Skajin tjetër të tubit të shkarkimit, sipas rastit të lidhjes, shtrëngojeni me aksesoret e tjerë.

Lavamani:




Sifoni:



Vendi i lidhjes duhet të sigurohet me morsetë për tuba (diametri i tendosjes 12-22 mm, në dyqanin e specializuar).

Në rastin e lidhjes në një sifon, duhet të keni kujdes që tubi i shkarkimit të futet në një lartësi minimumi 80 cm, dhe maksimumi 100 cm.

Shkarkimi i bazamentit:



Kujdes!

Dëmtime si pasojë e pikimeve apo rrjedhjes së ujit.


Tubi i shkarkimit të sigurohet kundër rrëshqitjes për jashtë. Mos e palosni tubin e shkarkimit. Diferenca e lartësisë midis vendit të vendosjes dhe shkarkimit prej maks. 100 cm.

Kujdes!


Uji i avulluar mund të thithet mbrapsht në tharëse dhe mund të dëmtojë pajisjen.

Kontrolloni nëse uji rrjedh me shpejtësi të mjaftueshme. Tubi i shkarkimit nuk duhet të jetë i mbyllur apo i bllokuar.


7. Nxirreni mbajtësen e ujit të kondensuar horizontalisht dhe boshatiseni.




8. Rrotulloni me 180° mbajtësen e ujit të kondensuar në pjesën e poshtme dhe hiqni kapakun e montuar aty.



9. Rrotulloni mbajtësen e ujit të kondensuar sërish me 180° dhe vendoseni kapakun në hapësirën që ndodhet në pjesën e sipërme të mbajtëses së ujit të kondensuar.



10. Shtyjeni mbajtësen e ujit të kondensuar derisa të mbërthehet.



Tani uji i kondensuar do të shkarkohet përmes tubit të shkarkimit në shkarkues ose në një lavaman.

Udhëzim: Dëshironi ta kaloni ujin e kondensuar sërish në mbajtësin e ujit të kondensuar, ndiqni të njëjtat hapa në rend të kundërt.

Kujdes!

Dëmet materiale dhe dëmtimet e pajisjes

Kur e devijoni ujin e kondensimit nga ena e ujit të kondensimit mund të rrjedhë pak ujë dhe të shkaktojë dëme materiale. Përpara përdorimit të pajisjes, mbërtheni tapën e mbylljes në tubin bashkues.



Pastrimi dhe mirëmbajtja

Pastroni pajisjen

⚠ Paralajmërim Rrezik vdekjeje!

Pajisja punon me energji elektrike. Ekziston rreziku i goditjes elektrike nëse do të prekni komponentët me tension. Prandaj ju lutem kini parasysh:

- Fikni pajisjen. Shkëpusni pajisjen nga rrjeti elektrik (hiqni spinën nga priza).
- Mos prekni ose mbani asnjëherë spinën me duar të njoma.
- Kur të hiqni spinën e korrentit nga priza, kapeni gjithmonë nga spina dhe asnjëherë nga kablli i korrentit, përndryshe mund të dëmtoni kabllin e korrentit.
- Mos ndërmerrni asnjë modifikim teknik në pajisje apo në veçoritë e saj.
- Riparimet apo çdo punim tjetër në pajisje duhet të bëhen vetëm nga shërbimi ynë i klientit ose nga një elektrikist. E njëjta gjë vlen edhe kur duhet të ndërroni kabllin e korrentit (nëse do jetë e domosdoshme).
- Kabllot rezervë të korrentit mund të porositen tek shërbimi ynë i klientit.



⚠ Paralajmërim Rrezik nga helmimi!

Agjentët pastrues që përmbajnë tretës, p.sh tretës pastrues, mund të lëshojnë avuj helmues. Mos përdorni agjentë pastrues që përmbajnë tretës.

⚠ Paralajmërim

Rrezik goditjeje elektrike/dëmsh materiale/dëmtimesh në pajisje!

Nëse në pajisje depërton lagështi, kjo mund të shkaktojë qark të shkurtër. Mos përdorni një larës me presion, pastrues me avull, tub ose pistoletë spërkatëse për të pastruar pajisjen tuaj.

Kujdes!

Dëme materiale/dëmtime në pajisje


Agjentët larës dhe agjentë trajtues para larjes (p.sh. pastruesi i njollave, spërkatësit para larjes, etj.) mund të shkaktojnë dëmtime nëse bien në kontakt me sipërfaqen e pajisjes. Prandaj ju lutemi kini parasysh:

- Mos lejoni që këta agjentë të bien në kontakt me sipërfaqet e pajisjes.
- Pastrojini pajisjen vetëm me ujë dhe me një pecetë të butë e të njomë.
- Pastrojini menjëherë mbetjet e detergjentit, spërkatësit apo mbetje të tjera.

Pastroni dyshtemenë

Kjo pajisje ka një funksion vetëpastrimi automatik. Pushi nga rrobat nuk duhet hequr pas çdo larjeje, por përkundrazi duhet të mblidhet te bazamenti.

Për të mos ndikuar në funksionimin e pajisjes, **duhet** që bazamentin (depozita e pushit dhe rrjeta e pushit) ta pastroni vetëm në rastet në vijim:


- Në ekran shfaqet udhëzimi: .
- Përpara kryerjes së procesit të mirëmbajtjes së pajisjes.

Ju mund ta pastroni **sipas dëshirës** bazamentin e pajisjes në çdo kohë.


Udhëzim: Pas përfundimit të procesit lëreni pajisjen rreth 30 minuta që të ftohet, më pas mund të filloni me pastrimin.

Pastroni dyshtemenë si më poshtë:


1. Hapni kapakun e mirëmbajtjes në dorezë.




2. Zhblokonte levën e kapakut të transformatorit.



3. Nxirrni duke e kapur tek doreza kapakun e transformatorit.




4. Largoni të gjithë pushin që ndodhet mbi kapakun e shkëmbyesit të nxehtësisë dhe të filtri i pushit.



Udhëzim: Bëni kujdes që të mos mbeten papastërti mbi guarnicionet e kapakut të shkëmbyesit të nxehtësisë.


5. Shpëlani mirë pjesën e brendshme të kapakut të shkëmbyesit të nxehtësisë dhe të rrjetës së pushit me ujë të rrjedhshëm dhe lëreni të thatet.



Udhëzime


- Në rast papastërtish të forta mund të përdorni një furçë për pastrimin.
- Mbani parasysh se pas larjes rrjeta e depozitës së pushit të rrobave duhet të thatet mirë. Rrjeta e lagësht e pushit mund të zgjatë kohën e tharjes dhe të ketë ndikim në rezultatin e tharjes.

6. Nxirrni jashtë horizontalisht depozitën e pushit.




Udhëzim: Depozita e pushit mund të ketë push dhe ujë të mbetur dhe mund të pikojë gjatë heqjes.

7. Hapni lart kapakun e depozitës së pushit dhe largoni pushin.




8. Shpëlani mirë rrjetën e depozitës së pushit të rrobave me ujë të rrjedhshëm dhe lëreni të thatet.



Udhëzime


- Në rast papastërtish të forta mund të përdorni një furçë për pastrimin.
- Nuk duhet të hiqni apo të dëmtoni guarnicionin e depozitës së pushit të rrobave.
- Depozita e pushit të rrobave mund të lahet edhe në lavastovilje.
- Mbani parasysh se pas larjes rrjeta e depozitës së pushit të rrobave duhet të thahet mirë.

9. Mbyllni depozitën e pushit.




Udhëzim: Bëni kujdes që ta mbyllni plotësisht depozitën e pushit.

10. Shtyni depozitën e pushit horizontalisht deri në fund.




11. Shtyni brenda kapakun e shkëmbyesit të nxehtësisë duke e kapur nga doreza.




Udhëzim: Ju mund ta shtyni brenda kapakun e shkëmbyesit të nxehtësisë vetëm kur depozita e pushit është brenda në pajisje.

12. Blllokoni levën e kapakut të transformatorit.



13. Mbyllni kapakun e kutisë së mirëmbajtjes.



Ju keni pastruar dyshemenë e pajisjes.

Kujdes!

Dëmtim objekteve/dëmtim në pajisje


Nëse do ta përdorni pajisjen pa kapës pushi (p.sh filtër pushi, depozitë pushi, në varësi të specifikimeve të pajisjes), ose nëse kapësi i pushit nuk është i plotë ose është me defekt, kjo mund të dëmtojë pajisjen tuaj.

Mos e përdorni pajisjen pa kapësin e pushrave ose me një kapës pushrash që nuk është i plotë apo që është i dëmtuar.


Pastrojeni sensorin e lagështisë

Udhëzim: Sensori i lagështisë mat shkallën e lagështisë së rrobave. Pas një përdorimi të gjatë, mund të depozitohen mbeturina të vogla bigorri ose ilaçi a zbutësi rrobash. Hiqni rregullisht depozitimet, përndryshe rezultati i tharjes mund të ndikohet.

1. Hapni derën.



2. Pastrojeni sensorin e lagështisë me një sfungjë të ashpër.



Kujdes!


Sensori i lagështisë mund të dëmtohet.

Sensori i lagështisë është prej inoksi. Mos e pastroni sensorin me solucione agresive dhe tel.


Pastroni filtrin që ndodhet në mbajtësin e ujit të kondensuar

Udhëzim: Filtri rrjetë në enën e ujit të kondensimit shërben për të pastruar ujin e krijuar nga kondensimi, i cili përdoret për pastrimin automatik të kësaj pajisjeje.

1. Nxirreni enën e ujit të kondensimit duke e mbajtur horizontalisht.




2. Dërdheni ujin e kondensuar.
3. Hiqni filtrin rrjetë.



4. Pastrojeni filtrin rrjetë me ujë të rrjedhshëm të ngrohtë ose lajeni në enëlarëse.

Udhëzim: Në rast papastërtish të forta mund të përdorni një furçë për pastrimin.

5. Futeni filtrin rrjetë derisa të ndieni mbërthimin e tij.



Kujdes!

Pa filtrin, pushi mund të futet brenda në pajisje dhe ta dëmtojë atë.

Përdoreni pajisjen vetëm me filtrin rrjetë të vendosur.

6. Futeni enën e ujit të kondensimit derisa të ndieni mbërthimin e saj.



Mirëmbajtja e pajisjes

Pajisja ofron një program shtesë pastrimi, të cilin mund ta përdorni për mirëmbajtjen e pajisjes:

- Me mirëmbajtjen e thjeshtë të pajisjes, ju largoni grumbullimet e ndotjeve të lehta të mundshme në pajisje.
- Me mirëmbajtjen intensive të pajisjes, ju largoni grumbullimet e ndotjeve të forta të mundshme në pajisje, si dhe aromat pas një periudhe të gjatë mospërdorimi të saj.

Para se të kryeni mirëmbajtjen e pajisjes duhet të përgatitni procesin e mirëmbajtjes.



Paralajmërim

Rrezik përvëlimi\Dëmtime fizike dhe dëmtime në pajisje!

Uji i vluar ose i nxehtë mund të shkaktojë përvëlime të rënda si edhe dëmtime fizike apo dëmtim të pajisjes, nëse do të tundet apo do të rrjedhë. Mos përdorni ujë të zier për këtë pajisje, apo elementët dhe aksesorët e saj. Shmangni kontaktin me ujin e nxehtë apo me avujt e ujit.



Paralajmërim

Rrezik helmimi/dëmsh materiale!

Uji i kondensuar nuk është ujë i pijshëm dhe mund të jetë i kontaminuar me pluhura. Uji i kondensuar i kontaminuar mund të jetë i rrezikshëm për shëndetin dhe mund të shkaktojë dëme materiale. Mos e pini apo përdorni atë.


Përgatitni mirëmbajtjen e pajisjes

Përgatitni pajisjen për mirëmbajtje


Pajisja duhet të përgatitet **para** një procesi të thjeshtë apo intensiv mirëmbajtjeje.

Përgatitni pajisjen për mirëmbajtje si më poshtë:


1. Pastroni bazamentin. → *Faqja 36*
2. Hapni derën.
3. Nxirrini rrobat.



4. Mbyllni derën.
5. Nxirrreni mbajtësen e ujit të kondensuar horizontalisht dhe boshatiseni.



6. Shtypni ①, për të ndezur pajisjen.




Tani pajisja është gati për mirëmbajtje.

Përgatitni depozitën e ujit të kondensuar për mirëmbajtje


Nëse uji i kondensuar i pajisjes shkarkohet përmes tubit të shkarkimit, depozita e ujit të kondensuar duhet të përgatitet **para** një procesi të thjeshtë apo intensiv mirëmbajtjeje.

Përgatitni depozitën e ujit të kondensuar për mirëmbajtje si më poshtë:

1. Hiqni bllokuesin nga thellësia e mbajtëses së ujit të kondensuar.



2. Rrotulloni me 180° mbajtësen e ujit të kondensuar në pjesën e poshtme dhe vendosni kapakun.



3. Pastroni filtrin që ndodhet tek ena e ujit të kondensimit. → *Faqja 39*
Tani depozita e ujit të kondensuar është gati për mirëmbajtje.

Udhëzim: Nëse uji i kondensuar i pajisjes shkarkohet përmes tubit të shkarkimit, bëni këto veprime në rend të kundërt **pas** një procesi të thjeshtë apo intensiv mirëmbajtjeje.

Kryeni një mirëmbajtje të thjeshtë të pajisjes


Ju mund të kryeni një mirëmbajtje të thjeshtë të pajisjes, për të larguar nga pajisja grumbullimet e ndotjeve të lehta të mundshme.


Udhëzime


- Pas një kohë të caktuar përdorimi vetë pajisja rekomandon automatikisht një proces mirëmbajtje të thjeshtë. Në ekran shfaqet **CE** para fillimit të programit për 5 sekonda si edhe pas përfundimit të programit. Ky udhëzim përsëritet, derisa të keni kryer plotësisht mirëmbajtjen e plotë të pajisjes.
- Procesi i mirëmbajtjes së thjeshtë të pajisjes zgjat rreth 1 orë.

Kryeni një mirëmbajtje të pajisjes si më poshtë:

1. Përgatitni mirëmbajtjen e pajisjes. → *Faqja 41*
2. Zgjidhni programin në pozicionin 1.




3. Shtypni dhe mbani shtypur  Drying Aim * (Qëllimi i tharjes) dhe në të njëjtën kohë:
4. Zgjidhni programin në pozicionin 4.




Në ekran shfaqen me radhë njëherë **CE** dhe një herë kohëzgjatja e programit.

5. Hidhni rreth 1 ½ litër ujë të ngrohtë nga çezma në kutinë e ujit të kondensimit.



Udhëzim: Në çdo kohë mbajeni horizontalisht kutinë e mbushur të ujit të kondensimit në mënyrë që të mos ketë derdhje të lëngut.

6. Shtyjeni mbajtësen e ujit të kondensuar derisa të mbërthehet.




7. Shtypni mbi **Start/▶||| Reload**(Start/ Pauzë).


Mirëmbajtja e pajisjes fillon dhe ju do të dëgjoni një sinjal akustik.

Në fund të procesit të mirëmbajtjes së pajisjes në ekran shfaqet **End** dhe dëgjohet një sinjal.


8. Nxirreni mbajtësen e ujit të kondensuar horizontalisht dhe boshatiseni.



9. Shtyjeni mbajtësen e ujit të kondensuar derisa të mbërthehet.



10. Shtypni **Ⓢ**, për të fikur pajisjen.



Ju keni kryer procesin e mirëmbajtjes së pajisjes.

Bëni mirëmbajtjen intensive të pajisjes

Ju mund ta ekzekutoni procesin intensiv të mirëmbajtjes së pajisjes për të larguar grumbullimet e ndotjeve të forta të mundshme në pajisje dhe aromat e mundshme pas një periudhe të gjatë mospërdorimi të saj mbi një muaj.

Udhëzime

- Mirëmbajtja intensive e pajisjes zgjat rreth 4 orë. Kohëzgjatja mund të zgjatet, nëse ju nuk do të kryeni në kohë veprimet e nevojshëm gjatë programit.
- Mirëmbajtja intensive e pajisjes nuk duhet të ndërpritet pas startit të programit.
- Për mirëmbajtjen intensive të pajisjes ju nevojitet një solucion mirëmbajtës origjinal, të cilin e gjeni tek shërbimi i klientit me numër: **00311829**. Të dhënat e kontaktit për të gjitha vende do t' i gjeni në listën e shërbimit të klientit që do ta merrni bashkë me pajisjen.

⚠ Paralajmërim

Rrezik lëndimi/zjarri/dëmsh materiale/dëmtimesh në pajisje!

Përdorimi i pjesëve të këmbimit dhe aksesorëve të markave të tjera është i rrezikshëm dhe mund të rezultojë në lëndime, dëme materiale ose në dëmtime në pajisje.

Për arsye sigurie, përdorni vetëm pjesë këmbimi dhe aksesorë origjinale.


Kujdes!


Dëme materiale/dëmtime në pajisje

Nëse hidhni sasinë e gabuar të detergjentit apo agentit larës në pajisje, kjo mund të rezultojë në dëme materiale ose në dëmtime në pajisje. Detergjentet/produktet e kujdesit/agentët pastrues dhe zbutësit përdorini në përputhje me udhëzimet e prodhuesve.


Kryeni një mirëmbajtje të pajisjes si më poshtë:

1. Përgatitni mirëmbajtjen e pajisjes. → *Faqja 41*
2. Zgjidhni programin në pozicionin 1.



3. Shtypni dhe mbani shtypur  Drying Aim * (Qëllimi i tharjes) dhe në të njëjtën kohë:

4. Zgjidhni programin në pozicionin 4.




Në ekran shfaqen me radhë njëherë **CP1** dhe një herë kohëzgjatja e programit.


5. Shtypni mbi **+**.

Në ekran shfaqen në mënyrë të alternuar **CP2** dhe kohëzgjatja e programit.

6. Nxirreni mbajtësen e ujit të kondensuar horizontalisht dhe boshatiseni.




7. Hidhni një shishe nga produkti original i kujdesit për pajisjen dhe rreth 1 ½ litër ujë të ngrohtë nga çezma në kutinë e ujit të kondensimit.



Udhëzim: Në çdo kohë mbajeni horizontalisht kutinë e mbushur të ujit të kondensimit në mënyrë që të mos ketë derdhje të lëngut.

8. Shtyjeni mbajtësen e ujit të kondensuar derisa të mbërthehet.




9. Shtypni mbi **Start/**  **Reload**(Start/ Pauzë).


Mirëmbajtja e pajisjes fillon dhe ju do të dëgjoni një sinjal akustik.

Pas rreth 3 orësh pajisja e stopon procesin e mirëmbajtjes dhe në ekran pulson koha e mbetur e programit.

10. Nxirreni mbajtësen e ujit të kondensuar horizontalisht dhe boshatiseni.




- 11.** Hidhni rreth 1 ½ litër ujë të ngrohtë nga çezma në kutinë e ujit të kondensimit.




Udhëzim: Në çdo kohë mbajeni horizontalisht kutinë e mbushur të ujit të kondensimit në mënyrë që të mos ketë derdhje të lëngut.

- 12.** Tundeni me kujdes horizontalisht depozitën e ujit të kondensuar dhe zbrazeni atë, për të shpëlarë kështu mbetjet e degjergjentit mirëmbajtjes.




- 13.** Hidhni rreth 1 ½ litër tjetër ujë të ngrohtë nga çezma në kutinë e ujit të kondensimit.
- 14.** Shtyjeni mbajtësen e ujit të kondensuar derisa të mbërthehet.




- 15.** Shtypni mbi **Start/**  **Reload**(Start/ Pauzë).

Mirëmbajtja e pajisjes vazhdon. Në fund të procesit të mirëmbajtjes së pajisjes në ekran shfaqet **End** dhe dëgjohet një sinjal.

- 16.** Zbrazeni sërish mbajtësen e ujit të kondensuar.
- 17.** Shtyjeni mbajtësen e ujit të kondensuar derisa të mbërthehet.








- 18.** Shtypni , për të fikur pajisjen.



Ju keni kryer procesin e mirëmbajtjes së pajisjes.

Ndihmë për pajisjen

Defektet	Shkaku / Zgjidhja
Pajisja nuk starton	Kontrolloni spinën e kordonit elektrik dhe siguresat.
Pajisja nuk reagon ndaj futjes së dhënave dhe në ekran tregohet:  R Ir	<ul style="list-style-type: none"> ■ Filtri i pushit që është i papastër ose i lagësht mund të ndikojë në rrymën e ajrit që qarkullon në pajisje kur temperaturat e mjedisit janë të ulëta. <ul style="list-style-type: none"> - Pastroni bazamentin dhe thani mirë filtrin rrjetë të pushit. → <i>Faqja 36</i> - Fikni pajisjen dhe ndizeni përsëri. - shtypni Start/  Reload (Start/Pauzë) për ta nisur programin nga e para.
Formimi i rrudhave.	<ul style="list-style-type: none"> ■ Mund të jetë tejkalluar sasia e ngarkesës ose është zgjedhur një program i gabuar për një lloj tekstili. Tek tabela e programit gjeni të gjithë informacionet e nevojshme. → <i>Faqja 23</i> ■ Rrobat nxirrihi nga kazani, direkt pas tharjes. Duke i lënë gjatë në kazan ato rrudhosen.
Uji del jashtë.	<ul style="list-style-type: none"> ■ Pajisja mund të anojë. Niveloni pajisjen. ■ Sigurohuni, që në dysheme: <ul style="list-style-type: none"> - kapaku i adaptorit të nxehtësisë është vendosur në mënyrë korrekte. - guarnicioni i kapakut të adaptorit të nxehtësisë nuk është i ndotur. → <i>Faqja 36</i> ■ Kur tubi opsional i shkarkimit* është instaluar, sigurohuni që tubi i shkarkimit të jetë lidhur si duhet. → <i>Faqja 32</i>
Pajisja është në gjendje pauze, por kazani vazhdon të rrotullohet.	Pajisja ka identifikuar një temperaturë të lartë dhe ka nisur procesin "CoolDown". Rregullimi i temperaturës mund të zgjasë deri në 10 minuta. Ju mund ta ndërpritni në çdo kohë procesin "CoolDown" duke hapur derën.
Programi nuk starton	<p>Sigurohuni që</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ dera është mbyllur ■ Child Lock 3 sec.  (Sistemi i sigurisë për fëmijët 3sek.) është çaktivizuar ■ butoni Start/  Reload (Start/Pauzë) është shtypur <p>Udhëzim: Nëse është vendosur një nisje e vonuar e programit nëpërmjet opsionit — Finished in  (Gati në), programi fillon në një moment të mëvonshëm të programuar.</p>
Kohëzgjatja e treguar e programit ndryshon gjatë procesit të tharjes.	Nuk është defekt. Sensori i lagështisë përcakton lagështinë e mbetur tek rrobat dhe përshtat kohëzgjatjen e programit (përveç programit kohor).

<p>Rrobat nuk thahen si duhet ose janë akoma shumë të njoma.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ■ Pas përfundimit të programit rrobat e ngrohta ndjehen më të lagështa se sa janë realisht. Shtrijini rrobat dhe lëriini të ftohen. ■ Përshtatni rezultatin e tharjes ose rrisni shkallën e tharjes. Kjo zgjat kohën e tharjes kur temperatura mbetet e njëjtë. ■ Zgjidhni programin kohor për pastharjen e rrobave që kanë akoma mbetur të njoma. ■ Zgjidhni programin kohor për një sasi të vogël ngarkese. ■ Mos e tejkaloni sasinë maksimale të ngarkesës së një programi. → <i>Faqja 23</i> ■ Pastrojini sensorin e lagështisë tek kazani. Një shtresë e hollë bigorri ose mbetjet e detergjentit dhe të produktit të kujdesit për rrobat mund të depozitohen mbi sensor dhe të ndikojnë në funksionimin e tij. → <i>Faqja 39</i> ■ Procesi i tharjes është ndërprerë nga ndërprerja e rrymës elektrike, nga mbushja plot e mbajtësit të ujit të kondensuar ose nga tejkalimi i kohës maksimale të tharjes.
<p>Koha e tharjes shumë e gjatë.</p>	<p>Udhëzim: Respektoni edhe këshillat për veshjet. → <i>Faqja 26</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Pajisja mund të jetë e ndotur me push. Kjo shkakton një kohë më të gjatë tharjeje. <ul style="list-style-type: none"> - Pastroni bazamentin. → <i>Faqja 36</i> - Kryeni një tharje të plotë me rroba që nuk janë tharë më parë dhe me një ngarkesë më të madhe se 3 kg. <p>Udhëzim: Vetëpastrimi automatik i pajisjes përdor ujin e kondensimit nga rrobat tuaja. Kur thani vazhdimisht sasi rrobash me peshë më të vogël se 3 kg, uji i kondensimit nga rrobat tuaja nuk mjafton që të kryhet vetëpastrimi automatik i pajisjes. Thani gjithmonë rroba që nuk janë tharë më parë dhe që gjithmonë kanë një peshë më të madhe se 3 kg.</p> ■ Shkëmbyesi i nxehtësisë mund të jetë i ndotur me push. <ul style="list-style-type: none"> - Ekzekutoni procesin e mirëmbajtjes së thjeshtë të pajisjes. → <i>Faqja 42</i> ■ Rrjeta e lagësht e pushit mund të zgjatë kohën e tharjes dhe të ketë ndikim në rezultatin e tharjes. Thani mirë rrjetën e pushit të bazamentit pas shpëlarjes së saj. → <i>Faqja 36</i> ■ Vrima e futjes së ajrit në pajisje, e cila është bllokuar ose nuk është e lirë, mund të zgjatë kohën e tharjes. Mbani të lirë vrimën e futjes së ajrit. ■ Temperatura e ambientit më e ulët se 15°C dhe më e lartë se 30°C mund të zgjatë kohën e tharjes dhe të ketë ndikim në rezultatin e tharjes. ■ Qarkullimi i pamjaftueshëm i ajrit në dhomë mund të zgjatë kohën e tharjes. Ajrosni dhomën mjaftueshëm.
<p>Erëra të rënda në pajisje</p>	<p>Bëni mirëmbajtjen intensive të pajisjes. → <i>Faqja 43</i></p>
<p>Lagështia e dhomës rritet.</p>	<p>Ajrosni hapësirën mjaftueshëm.</p>
<p>Zhurma të pazakonta gjatë tharjes.</p>	<p>Gjatë tharjes krijohen zhurma si pasojë e punës së pompës dhe të kompresorit. Kjo nuk nënkupton një defekt funksionimi në pajisje.</p>

Megjithëse është kryer procesi i tharjes pajisja duket e ftohtë.	Nuk është defekt. Pajisja me pompë nxehtësie than në mënyrë efektive me temperatura të ulëta.
Programi i tharjes u ndërpre.	Nëse programi i tharjes ndërpritet si pasojë e ikjes së korrentit, startojeni programin sërish ose nxirri dhe shtroni rrobat.
Në mbajtësen e ujit të kondensuar ka ujë të mbetur, edhe pse tubi i shkarkimit* është i lidhur tek pajisja.	Nëse tubi i shkarkimit* opsional është instaluar, në mbajtësen e ujit të kondensuar ka mbetje uji si pasojë e funksionit vetë-pastrues të pajisjes.
* sipas përbërjes së pajisjes ose aksesorit në dispozicion	

Udhëzim: Nëse nuk mund ta riparoni vetë një defekt duke fikur dhe ndezur pajisjen, drejtohuni shërbimit të klientit. → *Faqja 53*



Transportimi i pajisjes



Paralajmërim

Rrezik lëndimi/zjarri/dëmsh materiale/dëmtimesh në pajisje!

Nëse do ta ngrini apo lëvizni pajisjen duke e kapur tek ndonjë nga pjesët e dala të saj (p.sh dera e pajisjes), këto pjesë mund të thyhen dhe mund t'ju lëndojnë.

Mos e lëvizni pajisjen duke e kapur tek ndonjë nga pjesët e saj të dala.




Paralajmërim

Rrezik lëndimi!


- Pajisja është shumë e rëndë. Ngritja e saj mund të rezultojë në lëndimin tuaj.
Mos e ngrini pajisjen i vetëm.
- Cepat e pajisjes janë shumë të mprehtë dhe mund t'ju presin duart.
Mos e ngrini pajisjen duke e kapur tek cepat e saj të mprehtë. Vishni doreza mbrojtëse për ta ngritur atë.

Parapërgatiteni pajisjen për transportimin, si më poshtë:

1. Nxirreni mbajtësen e ujit të kondensuar horizontalisht dhe boshatiseni.



2. Fusni sërish mbajtësen e ujit të kondensuar në pajisje derisa ta dëgjoni të kërcasë.



3. Ndizni pajisjen.
 4. Vendosi programin e dëshiruar.
 5. Shtypni **Start/Reload** (Start/Pauzë).
 6. Prisni 5 minuta.
Ujit i kondensuar do të pompohet jashtë.
 7. Zbrazni sërish mbajtësen e ujit të kondensuar.
 8. Nëse është i instaluar, hiqeni tubin e shkarkimit nga lavamani, sifoni ose nga shkarkuesi. → *Faqja 32*
- Kujdes!**
Sigurojeni tubin e shkarkimit në pajisje kundër rrëshqitjes jashtë. Mos e palosni tubin e shkarkimit.
9. Fikni pajisjen.
 10. Shkëputni spinën e kordonit elektrike të pajisjes nga rrjeti elektrik.
Pajisja tani është gati për transportim.

Kujdes!

Dëmtime fizike dhe dëmtime në pajisje

Pavarësisht shkarkimit të ujit, në pajisje mbetet gjithmonë pak ujë. Uji i mbetur mund të rrjedhë dhe të shkaktojë dëme. Për këtë arsye, transportojeni pajisjen vertikalisht.



Vlerat e konsumit

Tabela e vlerave të konsumit

Programi	Numri i rrotullimeve me të cilin janë shtrydhur rrobat (në U/min)	Kohëzgjatja** (në min)		Konsumi i energjisë** (në kWh)	
Cottons (Pambuk)		9 kg	4,5 kg	9 kg	4,5 kg
E thatë për dollap	1400	152	99	1,81	1,09
	1000	171	109	2,10	1,24
	800	190	119	2,39	1,39
Tharje me hekurosje	1400	115	74	1,24	0,73
	1000	134	84	1,53	0,88
	800	153	94	1,82	1,03
Easy-Care (Larje e thjeshtë)		3,5 kg		3,5 kg	
E thatë për dollap	800	64		0,58	
	600	73		0,69	

* Rregullimet e programit sipas EN61121 në fuqi duke përdorur tuba shkarkimi të jashtme.

** Vlerat mund të devijojnë në krahasim me vlerat e dhëna në varësi të llojit të tekstilit, përbërjes së rrobave që do të thahen, lagështisë së mbetur në tekstile, të gradacionit të vendosur të tharjes, sasisë së mbushjes, të kushteve të ambientit si dhe të funksioneve shtesë të aktivizuara.

Program efikas për tekstilet prej pambuku

“Programi standard i të pambuktave” si më poshtë (me shenjën) është i përshtatshëm për tharjen e rrobave prej pambuku me lagështi normale dhe është shumë efikas për sa i përket konsumit të kombinuar të energjisë për tharjen e rrobave të njoma prej pambuku.

Program standard për të pambuktat sipas rregullores së BE 932/2012

Programi + rezultati i tharjes	Ngarkesa (në Kg)	Konsumi i energjisë (në kWh)	Kohëzgjatja e programit (në min)
Cottons (Pambuk) + E thatë për dollap	9/4,5	2,10/1,24	171/109

Rregullimi i programit për testimet dhe etiketimin e energjisë sipas direktivës 2010/30/BE.



Të dhënat teknike

Përmasat:

850 x 600 x 640 mm

(Lartësia x Gjerësia x Thellësia)

Pesha:

56 kg (sipas modelit)

Lidhja me rrjetin:

Tensioni i rrjetit 220 - 240 V, 50Hz

Tensioni nominal 10 A

Fuqia nominale 800 W

Sasia maksimale e ngarkesës:

9 kg

Konsumi i energjisë në gjendje të

fikur:

0,10 W

Konsumi i energjisë në gjendje jo të

fikur:

0,10 W

Ndriçimi i brendshëm në kazan*

Temperatura e mjedisit**:

5 - 35°C

Ky produkt përmban burime drite me efikasitet energjiek të klasës F. Burimet e dritës ofrohen si pjesë këmbimi dhe mund të ndërrohen nga personeli i trajnuar.

* sipas pajimit të pajisjes

** Me një temperaturë mjedisi nën 16°C, funksioni si dhe kohëzgjatja maksimale prej 24 orësh, mund të kufizohet në funksionin — **Finished in** + ☺ (Gati në).



Hedhja e mbetjeve



Hidheni ambalazhin dhe pajisjen duke respektuar mjedisin.

Kjo pajisje është etiketuar në përputhje me direktivën evropiane 2012/19/BE lidhur me pajisjet e vjetra elektrike dhe elektronike (waste electrical and electronic equipment – WEEE). Direktiva përcakton kornizën për kthimin dhe riciklimin e pajisjeve të vjetra në gjithë vendet e BE-së.

Kujdes!

Rrezik vdekjeje/rrezik helmimi/dëmtim objektesh dhe pajisjesh

Pajisja përmban lëndë ftohëse R290 miqësore me ambientin por të djegshme. Eliminimi jo i rregullt i tyre mund të shkaktojë djegie apo helmime. Eliminoni si duhet pajisjen dhe mos dëmtoni tubat e sistemit të qarkullimi të lëndëve ftohëse.



Shërbimi i klientit

Nëse nuk mund ta eliminoni vetë një defekt duke e fikur dhe ndezur pajisjen, ju lutemi t'i drejtoheni shërbimit të klientit. → Lista e shërbimit të klientit bashkëngjitur ose në brendësi të kapakut

Ne gjejmë gjithmonë një zgjidhje të përshtatshme, edhe për të shmangur vizitat e panevojshme të teknikëve.

Jepini shërbimit të klientit numrin e produktit (E-Nr.) dhe numrin e prodhimit (FD) të pajisjes.

E-Nr. _____ FD _____

E-Nr. Numri i produktit
FD Numri i prodhimit

Këto të dhëna do t'i gjeni *në varësi të modelit:

Brenda te dera*/kapaku i hapur i shërbimit* dhe në pjesën e pasme të pajisjes.

Kini besim në kompetencën e prodhuesit.

Drejtoheni tek ne. Kështu ju siguroheni që riparimi do të kryhet nga teknikë servisi të kualifikuar, të pajisur me pjesë këmbimi origjinale.





Ju falënderojmë që bletë një pajisje shtëpiake Bosch!

Regjistroni tani pajisjen tuaj të re në MyBosch dhe përfitonit direkt nga:

- **Këshillat dhe truket e ekspertëve për pajisjen tuaj**
- **Opsionet për zgjatjen e afatit të garancisë**
- **Zbritjet për aksesoret dhe pjesët e këmbimit**
- **Manuali dixhital dhe të gjitha të dhënat e gatshme të pajisjes**
- **Akresi i lehtë në shërbimin për pajisjet shtëpiake Bosch**

Regjistrim pa pagesë dhe i lehtë – edhe nga telefonat celularë:

www.bosch-home.com/welcome

BOSCH
HOME APPLIANCES
SERVICE

Po kërkoni për ndihmë? Atë do ta gjeni këtu.

Këshillim ekspert për pajisjet tuaja shtëpiake Bosch, ndihmë në raste problemesh ose riparim nga ekspertët e Bosch.

Zbuloni gjithçka rreth mënyrave të shumta që Bosch mund t'ju mbështesë:

www.bosch-home.com/service

Të dhënat e kontaktit për të gjitha shtetet jepen të renditura në direktorinë e shërbimit bashkëngjitur.

Robert Bosch Hausgeräte GmbH

Carl-Wery-Straße 34

81739 München, GERMANY

www.bosch-home.com



9001606893 (0104)

sq